



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Nr. (21291-04004)3881/725 i Regj. Them.  
Nr. (11-2009-4169)2653 i Vendimit

Datë rregjistrimi 31/10/2009  
Datë vendimi 05/10/2009

**V E N D I M**

“Ne emër të Republikës”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë nga:

**Gjyqtar- Kryesues : Ervin METALLA**

**Gjyqtar- Relatore : Dhurata BILO**

**Gjyqtar : Markelian KOÇA**

Asistuar nga sekretare Florida Meni, sot, me 05/10/2009, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike çeshtjen civile nr. 3881/725 akti qe i perket:

**PADITES:** 1. Ana Mitro(Vevecka), e bija e Jorgjit e dtl 18.12.1937, banuese ne Durres, lagja nr 1, rruga “Taulantia”, pallati nr 1000/1.

2. Fotaq Konomi, i biri i Ksenofonit, i dtl 05.11.1937, banues ne Vlore, lagja Uji i Ftohte.

3. Vasillaq Goxhomani, i biri i Kristaqit dhe i Evdhoqise, i dtl 18.08.1932, banues ne Berat, lagja “Mangalem”.

4. Eleni Mima, e bija e Kostandinit dhe e Milikes, e dtl 06.03.1946, banuese ne Tirane, lagja nr 9, rruga “Konferenca e Pezes”, pall. Nr 150/1.

Te perfaqesuar ne gjykim prej av. Flutura Kona me prokure te posacme Nr.7296 Rep, Nr. 1690/2 Kol, date 03.12.2008 dhe me prokure te posacme Nr.1632 Rep, Nr.1326 Kol, date 08.09.2009.

**NDERHYRES KRYESOR:** 1. Polikseni Mima, e bija e Kostandinit dhe e Aspasise, shtetase Greke, banuese ne Athine, Zeografu Atikis,

2. Marjeta Mima, e bija e Vasilit dhe e Virgjinise, e dtl 1953, lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane , bulevardi “At Gjergj Fishta”, kulla nr 4.

Te perfaqesuar ne gjykim prej av.Erinda Ballanca me prokure te posacme Nr.7109 Rep, Nr.2324 Kol date 24.09.2009 dhe me prokure te posacme date 04.09.2009.

**TE PADITUR:** 1. Agjensia Kombetare e Kthimit dhe e Kompensimit te Pronave, Tirane, adresa, bulevardi “Skenderbej”, kulla, nr 2, kati 7.

2. Zyra Rajonale e Kthimit dhe e Kompensimit te Pronave, Qarku Durres, me adrese, "Sheshi Iliria", prane Prefektures Durres. Te perfaqesuar ne gjykim nga Avokatia e Shtetit, Zyra Rajonale Durres, av. Lorval Petani.

### **OBJEKTI I PADISE DHE NDERHYRJES KRYESORE:**

- Ndryshimi i vendimeve:

1) Nr. 384, dt 04.01.2008, Z.R.K.K.Pronave te Qarkut Durres dhe nr 1070, dt 24.09.2008, te A.K.K.Pronave Tirane, duke njohur te drejten e pronesise dhe duke kthyer ne natyre, nje toke me siperfaqe 1.575.900 m2.

2) Nr. 380, dt 28.12.2007, Z.R.K.K.Pronave te Qarkut Durres dhe nr 1069, dt 24.09.2008, te A.K.K.Pronave Tirane, duke njohur te drejten e pronesise dhe duke kthyer ne natyre, nje toke me siperfaqe 1.820.000 m2.

3) Nr. 379, dt 28.12.2008, Z.R.K.K.Pronave te Qarkut Durres dhe nr 1071, dt 24.09.2008, te A.K.K.Pronave Tirane, duke njohur te drejten e pronesise dhe duke kthyer ne natyre, nje toke me siperfaqe 25.597.200 m2.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18/1, 3, I ligjit nr 9235, dt 29.07.2004, "Per kthimin dhe kompensimin e pronave" i ndryshuar, nenet 32, 202, 206/b te K. Pr. Civile.

Gjykata ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te ceshtjes, pasi analizoi ne teresi te gjitha provat shkresore, degjoi pretendimet perfundimtare te paditesave dhe nderhyresave kryesore, te cilet kerkuan: - pranimin e kerkesepadise, ndryshimin e vendimeve nr. 384, dt 04.01.2008, nr 380, dt 28.12.2007, nr nr. 379, dt 28.12.2008, te Z.R.K.K.Pronave te Qarkut Durres dhe nr 1070, dt 24.09.2008, nr 1069, dt 24.09.2008, nr 1071, dt 24.09.2008, te A.K.K.Pronave Tirane, duke njohur te drejten e pronesise dhe duke kthyer ne natyre, siperfaqet e lira te tokes, degjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesuesit te avokatures se shtetit, i cili kerkoi: - rrezimin e kerkesepadise.

### **V E R E N**

Paditesit, Ana Mitro(Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani dhe Eleni Mima, me kerkesepadi drejtuar Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres kane kerkuar: - Ndryshimin e vendimeve: 1) Nr. 384 dt 04.01.2008, Z.R.K.K.Pronave te Qarkut Durres dhe Nr. 1070, dt 24.09.2008, te A.K.K.Pronave Tirane, duke njohur te drejten e pronesise dhe duke kthyer ne natyre, nje toke me siperfaqe 1.575.900 m2. 2) Nr. 380, dt 28.12.2007, Z.R.K.K.Pronave te Qarkut Durres dhe Nr. 1069, dt 24.09.2008, te A.K.K.Pronave Tirane, duke njohur te drejten e pronesise dhe duke kthyer ne natyre, nje toke me siperfaqe 1.820.000 m2. 3) Nr. 379, dt 28.12.2008, Z.R.K.K.Pronave te Qarkut Durres dhe Nr. 1071, dt 24.09.2008, te A.K.K.Pronave



...ne, duke njohur te drejten e pronesisë dhe duke kthyer ne natyre, nje toke me sipërfaqe 25.597.200 m2.

Gjate gjykimit te ceshtjes, ne seance gjyqesore te dates 02.06.2009 u paraqit nga shtetaset Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, kerkesa per nderhyrje kryesore me objekt kerkimi, te te njejtin objekt qe ka edhe padia, kerkes e pranuar nga gjykata ne baze te nenit 194 te K.Pr.Civile.

Nepermjet kerkesepadis, paditesat dhe nderhyresit kryesor, pretenduan se:

- Ata jane trashegimtar ligjor te ish pronareve Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, fakt i cili vertetohet nepermjet deshmive te trashegimise ligjore te depozituara ne dosje.
- Trashegimlensesit e tyre, perpara vitit 1945, kane qene pronar te nje prone te ndodhur ne fshatin Rushkull dhe Hamallaj, te rrethit Durres.
- Prona e tyre, rezulton te jete e rregjistruar ne rregjistrat hipotekor te Zyres Vendore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Durres, si dhe ne rregjistrat kadastror, per here te pare ne vitin 1919, ne emer te te ndjerit Miltjadh Shallvari(daja i trashegimlensesave te paditesave), me emer te vjeter te prones "Cifliku Rushkull dhe Cifliku i Ri".
- Ne vitin 1933, pas vdekjes se Miltjadh Shallvarit, prona e mesiperme, nepermjet nje testamenti kaloi teresisht ne favor te ish- bashkeshortes se te ndjerit Miltjadh Shallvari, znj. Sllava Maria Lubica, transkriptimi i testamentit eshte pasqyruar ne noten e transkriptimit nr 527, volumi 11, dt 03.04.1940, te hipotekes Durres.
- Ne date 27.04.1940, znj.Sllava Maria Lubica, ka lidhur kontrate emfiteoze per kete prone me shoqerine Italiane agrikulturore E.I.A.A. Keto transaksione jane pasqyruar ne ne rregjistrat hipotekor, transkriptuar ne date 27.04.1940.
- Paditesat kane paraqitur ne gjykim, ne cilesine e proves edhe nje note transkriptimi, nr 126, volumi 15, date 29.05.1946, ne favor te shtetit shqiptar, kundra shoqerise italiane, E.I.A.A, nga rezulton se prona ne emer te Sllava Maria Lubices, dhe qe ishte mare ne emfiteoze nga shoqeria Italiane, kalon ne favor te shtetit Shqiptar, si prone e konfiskuar.
- Duke mos qene dakort me testamentin dhe disponimin e bere nga i ndjeri Miltiadh Shallvari, trashegimlensesit e paditesave, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqi Goxhomani dhe Ariadhni Konomi, e kane kundershtuar testamentin dhe disponimin e bere nga i ndjeri Miltiadh Shallvari, ne favour te ish-bashkeshortes se tij Sllava Maria Lubica Lampo, duke ngritur padi ne Gjykatën e Paqit Durres, qe ne vitin 1934, gjykim i cili ka vazhduar deri ne vitin 1946, dhe ka perfunduar me vendimin nr 52, dt 03.02.1946.
- Ne perfundim te ketij procesi gjyqesor, trashegimlensesit e paditesvae, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqi Goxhomani dhe Ariadhni Konomi, jane njohur bashkepronar mbi pronen "Cifliku Rushkull dhe Cifliku i Ri", se bashku me ish-bashkeshorten e te ndjerit Miltiadh Shallvari, duke u percaktuar edhe pjeset perkatese te seicilit bashkepronar.



- Prona nuk ka qene e Miltjadh Shallvarit por e te atit te tij Kostandin Shallvari, gjithashtu testamenti ne favour te bashkeshortes Sllava Maria Lubica, eshte i pavlefshem dhe pa pasoja juridike.
- Vendimi i mesiperm gjyqesor, qe ka njohur te drejten e pronesise se trashegimlensesve te paditesave mbi pronen e "Ciflikut Rrushkul", ne pjesen e dispozitivit citon se "Ky vendim nuk mund te rregjistrohet ne hipoteke per shkak te veprimit te reformes agrare".
- Mbi bazen e dokumentacionit te mesiperm, paditesat i jane drejtuar Komisionit te Kthimit dhe Kompensimit te Pronave me kerkese, per njohjen e te drejtes se pronesise dhe kthimin ne natyre te prones, qe rezulton te jete e lire ne kuptim te ligjit "Per Kthimin e Pronave".
- Zyra Rajonale e Kthimit dhe e Kompensimit te Pronave Durres, pasi ka marre ne shqyrtim kerkesen e ish-pronareve, fillimisht me vendimin nr 172, dt 01.08.2007, ka pranuar kerkesen e tyre per njohjen e te drejtes se pronesise dhe u ka kthyer ne natyre, nje siperfaqe prej 157.2 ha duke vazhduar me pas me procedurat per njohjen dhe kthimin e pjeses tjeter te prones.
- Zyra qendrore e Agjensise se Kthimit te Pronave, pasi ka shqyrtuar me inisiative vendimin nr 172, dt 01.08.2007, ka urdheruar shfuqizimin e tij dhe e ka kthyer dosjen per shqyrtim duke i lene si detyra Z.R.K.K.P. Durres te verifikojte korrespondencen me Ministrine e Mjedisit.
- Ne rishqyrtim, Z.R.K.K.Pronave Qarku Durres me vendimet nr 379, 380, 384 te dates 04.01.2008, ka rrezuar kerkesen e trashegimtareve te Jorgji Veveckes, Sofia Koleas, Ariadhni Konomit, Evdhoqes Goxhomanit dhe Kostandin Mimes, per njohjen e te drejtes se pronesise dhe kthimin ne natyre te prones se trashegimlensesve te tyre.
- Sipas Komisionit te Kthimit dhe Kompensimit te pronave, kerkesa e paditesave nuk eshte pranuar me pretendimin se: - prona figuron ne emer te ish-pronares Sllava Maria Lubica dhe pretenduesit ne asnje rast nuk figurojne pronar.
- Vendimi nr 52 dt 02.03.1946, i Kolegjit Arbitror prane Gjykates se Prefektures Durres qe ka njohur paditesat bashkepronar, nuk eshte transkriptuar ne hipoteke dhe si i tille nuk ka sjelle pasoja juridike.
- Vendimet e mesiperme te Z.R.K.K.Pronave Durres, po per te njejtat shkaqe jane lene ne fuqi nga A.Q.K.K.Pronave Tirane, nepermjet vendime nr 1069, 1070 dhe 1071, dt 24.09.2008, gje per te cilen trashegimtarete e ish-pronareve Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqi Goxhomanit dhe Ariadhni Konomi, jane paraqitur ne Gjykate per ti kundershtruar ne rruge gjyqesore.

**Gjatë gjykimit të çështjes rezultoi e provuar se :**

**Paditesat Ana Mitro(Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomanit, Eleni Mima dhe nderhyresit kryesor Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, jane trashegimtar ligjor te ish pronareve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomanit, Ariadhni Konomi fakt i cili vertetohet nepermjet deshmive te trashegimise ligjore nr 2049 date 31.05.2001 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, nr. 1134 date 23.06.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, nr. 1105 date**



1.06.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore, nr. 464 date 22.11.1993 Noteria Tirane, nr.704 date 16.07.1993 Noteria Tirane.

Paditesat dhe nderhyresit kryesor Ana Mitro(Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima, Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, i jane drejtuar Komisionit te Kthimit dhe Kompensimit te Pronave, Qarku Durres, me kerkese per njohjen e te drejtes se pronesise dhe kthimin ne natyre te prones te lene nga trashegimlensit e tyre **Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi.**

Zyra Rajonale e Kthimit dhe e Kompensimit te Pronave Durres, pasi ka marre ne shqyrtim kerkesen e trashegimtareve te ishpronareve, **fillimisht me vendimin nr 172, dt 01.08.2007**, u ka pranuar atyre kerkesen per njohjen e te drejtes se pronesise dhe u ka **kthyer ne natyre siperfaqen e tokes 157.2 ha**, si dhe ka vazhduar procedurat per njohjen dhe kthimin e pjeses tjeter te prones.

Zyra Qendrore e Agjencise se Kthimit te Pronave, pasi ka shqyrtuar me inisiative e saj vendimin nr. 172 dt 01.08.2007 te Z.R.K.K.Pronave Durres, me vendimin nr. 258 dt 01.10.2007 e ka shfuqizuar vendimin nr. 172 dt 01.08.2007 dhe ka kthyer dosjen per shqyrtim duke i lene si detyra Z.R.K.K.P. Durres, te verifikojte korrespondencen me Ministrine e Mjedisit.

Ne rishqyrtim i padituri, me vendimet nr. 379; 380; 384, ka rrezuar kerkesen e trashegimtareve te ish-pronareve Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, per njohjen e te drejtes se pronesise dhe kthimin ne natyre te prones se trashegimlensve te tyre, konkretisht:

1- Me vendimin nr. 380 dt. 28.12.2007, te Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Qarku Durres lene ne fuqi me vendimin nr. 1069 dt. 24.09.2008 te Agjencise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane eshte vendosur: *"Mos njohja e te drejtes se pronesise trashegimtareve te subjekteve pretendues si te shpronesuara Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi, qe dalin nga deshmite e trashegimive te dhena ne piken 3 te te ketij vendimi, per pronen me siperfaqe 1 820 000m2 e ndodhur ne fshatin Hamallaj (sektor) te rrethit te Durresit ne ZK 1925, me indeks harte K-34-88-(144-B, 146-A, 129-D, 161-B) me keto kufij: Veriu pas. Nr. 49, 54/2, 133/2 e kanali i hidrovorit; Jug -vija ndarese midis fshatit Rushkull-Hamllaj (sektor) Perendim -pasuria nr. 21/8, 21/6, Lindje -pas. Nr.133/2, 49, 139, 146, 87, per faktin se keta trashegimtare nuk legjitimohen si pale ne procesin administrativ per mangesite e dala ne pjesen pershkruese te vleresimit ligjor qe ndodhet ne dosje."*

2- Me vendimin nr. 379 dt. 28.12.2007 te Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Qarku Durres lene ne fuqi me vendimin nr. 1071 dt. 24.09.2008 te Agjencise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane eshte vendosur: *"Mos njohja e te drejtes se pronesise trashegimtareve te subjekteve pretendues si te shpronesuara Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima,*



Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, qe dalin nga deshmite e trashegimive te dhena ne piken 3 te te ketij vendimi, per pronen me sipërfaqe 25 597 200m<sup>2</sup> e ndodhur ne fshatin Rrushkull ne ZK 3241, me indeks harte te papercaktuar, pasi zona eshte jashte sistemit te ZVRPP Durres me keto kufij natyrale: Veriu Prona e vet, Jug-Lumi Erzen, Perendim Deti, Lindje Qani Hanem dhe Fuat Bej Toptani per faktin se, keta trashegimtare nuk legjitimohen si pale ne procesin administrativ per mangesite e dala ne pjesen pershkruese te vleresimit ligjor qe ndodhet ne dosje."

3-Me vendimin nr. 384 dt. 04.01.2008 te Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Qarku Durres lene ne fuqi me vendimin nr. 1070 dt. 24.09.2008 te Agjencise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane eshte vendosur: "Mos njohja e te drejtes se pronesise trashegimtareve te subjekteve pretendues si te shpronesuara Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, qe dalin nga deshmite e trashegimive te dhena ne piken 3 te te ketij vendimi, per pronen me sipërfaqe 1 575 900m<sup>2</sup> e ndodhur ne fshatin Hamallaj (sektor) te rrethit te Durresit ne ZK 1925, me indeks harte K-34-88-(144-B, 129-A, 129-B) me keto kufij: Veriu pas. Nr.20/1, 21/9; Jug -vija ndarese midis fshatit Rrushkull, Perendim -deti, Lindje - pas. Nr.21/9, 21/10, 134 pasi keta trashegimtare nuk legjitimohen si pale ne procesin administrativ per mangesite e dala ne pjesen pershkruese te vleresimit ligjor qe ndodhet ne dosje."

Nga permbajtja e vendimeve te kundërshtuara, rezulton se nga ana e te paditurit Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Qarku Durres eshte arritur ne konkluzionin se :

- paditesit nuk rezultojne te kene gezuar titullin e pronesise te vetem ose ne bashkepronësi per pronen e pretenduar.
- E gjithë prona rezulton ne emer te zj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe i eshte dhene me enfiteoze per 99 vjet shoqërisë E.I.I.A. ne vitin 1940 dhe me pas eshte sekuestruar nga shteti shqiptar ne 29.05.1945 kesaj shoqërie.
- Ankimuesit ne asnje rast nuk figurojne pronar ose bashkepronar.
- Vendimi i Gjykates Durres nr. 52 dt. 02.03.1946 i cili ka konsideruar te pavlefshem testamentin e lene nga Miltiadh Shallvari ne favor te Znj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe ka vendosur te njohe si bashkepronar Znj Maria Lubica Shallvari, Jorgji Vevecka Sofia Kolea Kostandin Mima Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi sipas pjeseve takuese, nuk eshte transkriptuar ne rregjistrat e hipotekes se asaj kohe e per pasoje nuk i ka sjelle efektet e veta juridike.

Bazuar ne kete arsyetim nga ana e te paditurit, Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Qarku Durres dhe te Agjencise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane eshte rrezuar kerkesa e paditesave, pasi sipas te paditurit nuk legjitimohen te iniciojne nje procedure administrative.

Mbi bazen e ketij arsjetimi u kerkua dhe rrezimi I kerkes padise se paditesave nga te paditurit, Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Qarku Durres dhe



gjensa e Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane te pefaqsuar ne gjykim nga Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durres.

Rezulton e provuar qe **prona objekt i ketij gjykimi e kerkuar nga paditesat dhe nderhyresit kryesor, rrjedh nga trashegimlensesi Miltiadh Shallvari, prone e cila figuron e rregjistruar ne rregjistrat e pasurive te paluajtshme prane Zyres se Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Durres dhe origjina e saj gjendet ne librin 10 te kadastrës, faqe nr. 21, 22, 23, 24, date 19.08.1919 dhe me numrat prej 31 deri ne 56, pranuar nga i padituri ne vendimet e kundërshtuara si dhe provuar me notat e transkriptimit.**

Ne keto nota transkriptimi te viteve 1919-1946, percaktohet shprehimisht se, kufizimet e pronës "Cifliku Rrushkull dhe Cifliku i Ri" jane: **L - cifliku ne posedim te shoqerise E.I.I.A, duke u ndare me te me shtylla cimentoje, te vendosura ndermjet dy pronave gjate gjithë ciflikut, prej Erzenit, ne vendin Shena Prende te Kulla; J - lumi Erzen; P - Deti Adriatik; V- pronat e Qanie Libohoves, Zija Toptanit, Fuat Toptanit, Ali Qoraliut dhe prej ketyre me nje hendek, prej vendit Kulla, der tek a ii quajtur Tana, pastaj prej lumit Vorbe, e me tutje nga Tarini dhe pastaj shtrihet deri ne vendin e quajtur shen Pjetri, kufij te konfirmuara nga tapit e ishpronarit Miltjadh Shallvari prej kadastrës se Durresit e Shijakut, ne date 19.08.1919**

Rezulton e provuar qe trashegimlensesi **Miltiadh Shallvari ka vdekur me 17.05.1933.**

Nga rregjistri i pasurive te paluajtshme rezulton qe ne vitin 1940, ne volumin 11 rep. me nr. rendor 527 faqe 32 vol 12 dosje artikull 117, kjo prone eshte transkriptuar ne favor te Znj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo, sipas nje **testamenti te lene nga trashegimlensesi Miltiadh Shallvari ne date 08.05.1929.**

Nga rregjistri i pasurive te paluajtshme rezulton se me nr. rendor 528 viti 1940 eshte rregjistruar heqja dore (renoncimi) i Edita Shallvarit e bija e trashegimlensetit Miltiadh Shallvari dhe Nikolo Shallvari vellai i trashegimlensetit Miltiadh Shallvari nga cdo lloj e drejte qe mund tu takoje per efekt trashegimie mbi **pronat Rrushkull dhe Cifliku i Ri**, ne favor te Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo.

Ne date 27.04.1940, eshte rregjistruar ne rregjistrat e pasurive te paluajtshme Durres nje kontrate **enfiteoze kunder Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo ne favor te shoqerise italiane E.I.I.A.**

Me noten e transkriptimit nr 126, volumi 15, date 29.05.1946, ne favor te shtetit shqiptar kundra shoqerise italiane E.I.A.A. rezulton se, prona e mesiperme me kufizimet: V - Ali Bej Qorralliu, Fuat bej Toptani , Zija bej Toptani; P- Deti; J- lumi Erzen dhe L-Qanie Hanemi, Fuat Bej Toptani, ne emer te Sllava Maria Lubices, dhe qe ishte mare ne enfiteoze nga shoqeria Italiane, **kalon ne favor te shtetit Shqiptar, si prone e konfiskuar ne zbatim te ligjit nr. 36 dt. 14.01.1945**



“Mbi konfiskimin e pasurive te shtetasve italiane dhe gjermane te ndodhura ne Shqiperi”.

Duke mos qene dakort me testamentin dhe disponimin e bere nga i ndjeri Miltiadh Shallvari, trashegimlensesit e paditesave, konkretisht **Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqi Goxhomani dhe Ariadhni Konomi**, e kane kundershtuar testamentin dhe disponimin e bere, nga i ndjeri Miltiadh Shallvari ne favor te ish- bashkeshortes se tij Sllava Maria Lubica Lampo, duke ngritur padi ne Gjykatën e Paqit Durrës qe ne vitin 1934, gjykim i cili ka vazhduar e perfunduar me vendimin nr 52, dt 03.02.1946.

Me vendimin gjyqësor nr. 52 dt. 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durrësit i formuem me Kolegj Arbitrar, Evdhoqi Goxhomani dhe Ariadhni Konomi, jane njohur bashkepronar mbi pronen “Cifliku Rushkull dhe Cifliku i Ri”, se bashku me ish-bashkeshorten e te ndjerit Miltiadh Shallvari, duke u percaktuar edhe pjeset perkatese te seicilit bashkepronar. Ne pjesen arsyetuese te vendimit rezulton se, prona nuk ka qene e Miltjadh Shallvarit, por e te atit te tij z.Kostandin Shallvari. Gjithashtu rezulton se, **testamenti ne favor te bashkeshortes Sllava Maria Lubica, eshte i pavlefshem dhe pa pasoja juridike.**

Vendimi i mesiperm gjyqësor, qe ka njohur te drejten e pronesise se trashegimlensesve te paditesave Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi mbi pronen e “Ciflikut Rrushkull dhe Cifliku i Ri”, ne pjesen e dispozitivit citon se: “Ky vendim nuk mund te rregjistrohet ne hipoteke per shkak te veprimit te reformes agrare”.

Gjykata çmon se padia e paditësave Ana Mitro(Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima dhe nderhyresit kryesor Polikseni Mima e Marjeta Mima, duhet pranuar pasi është e mbështetur në prova dhe në ligj.

Rezulton e provuar se, paditesat Ana Mitro(Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima dhe nderhyresit kryesor Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, jane trashegimtar ligjor te ish pronareve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe konkretisht: 1- Ana Mitro ( Vevecka ) dhe Pinellopi Samara (Vevecka ) trashegimtare ligjore te Jorgji Veveckes. 2- Fotaq Konomi, Milika Pjero, Nikollaq Konomi, Agallia Konomi dhe Androniqi Konomi trashegimtare ligjore te Ariadhni Konomit. 3- Vasillaq Goxhomani, Drita Goxhomani trashegimtare ligjore te Evdhoqes Goxhomani. 4- Eleni Mima, Polikseni Mima, Marjeta Mima, Emi Mima, Ravik Mima trashegimtare ligjore te Kostandin Mimes.

Keta trashegimtare jane njekohesisht, edhe trashegimtare ligjore te Sofija Koleas, dhe si te tille ata legjitimohen ne baze te nenit 32/a te K.Pr.Civile per te kerkuar rivendosjen e nje te drejte ose interesi te ligjshem qe u eshte shkelur, per te provuar perpara Gjykates se ata kane patur ne pronesi, prona te cilat perfshihen nga



jatimi i ligjit 9235 dt. 29.07.2004 i ndryshuar. Pra, kane patur cilesine si ish-pronar dhe se kjo prone iu eshte marre sipas akteve ligjore dhe nenligjore, vendimeve penale te gjykatave ose marre me cdo menyre tjeter nga shteti date 29.11.1944.

Gjykata konstaton kryesisht se ceshtja ben pjese ne juridiksionin gjyqesor sipas percaktimit te nenit 36 e vijues te K.Pr.Civile dhe ne baze te Nenit 41 e 42 e vijues te K.Pr.Civile ajo eshte kompetente per shqyrtimin e saj.

Referuar permbajtjes se vendimeve te kundershutuara te Komisionit te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave, nr. 380 dt. 28.12.2007, nr. 1069 dt. 24.09.2008 nr. 379 dt. 28.12.2007 nr. 1071 dt. 24.09.2008 nr. 384 dt. 04.01.2008 nr. 1070 dt. 24.09.2008, rezulton se nga ana e te paditurit Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Qarku Durres dhe te Agjencise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave, si dhe pefaqsesit te tyre ne gjykim, Avokatures se Shtetit, Zyra Vendore Durres eshte rrezuar kerkesa e paditesave, me aresyetimin

se:

- 1- Vendimi gjyqesor nr. 52 dt. 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durresit nuk rezulton te jete i formes se prere.
- 2- Vendimi gjyqesor nr. 52 dt. 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durresit. i cili ka konsideruar te pavlefshem testamentin e lene nga Miltiadh Shallvari ne favor te Znj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe ka vendosur te njohe si bashkepronar Znj Maria Lubica Shallvari, Jorgji Vevecka Sofia Kolea Kostandin Mima Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi sipas pjeseve takuese, nuk eshte transkriptuar ne rregjistrat e hipotekes se asaj kohe e per pasoje nuk i ka sjelle efektet e veta juridike, dhe se paditesat nuk e kane poseduar ndonjehere pronen objekt kerkimi.
- 3- E gjithë prona rezulton ne emer te zj Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo dhe i eshte dhene me enfiteoze per 99 vjet shoqerise E.I.I.A. ne vitin 1940 dhe me pas eshte sekuestruar nga shteti shqiptar ne 29.05.1945 kesaj shoqerie.

Gjithashtu nga vendimet e kundershutuara nga i padituri Komisioni Kthimit dhe Kompesimit te Pronave nuk rezulton e qarte nese sipas tij, kujt i perket prona objekt kerkimi. I perket shtetases italiane Sllava Ljubica Maria Amalia Lampo? Shoqerise italiane E.I.I.A? Apo shtetit shqiptar.

**1. Për sa i përket pikës së parë, vendimi gjyqesor nr. 52 dt. 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durresit i formuem me Kolegj Arbitrar nuk rezulton te jete i formes se prere, gjykata nisur nga provat e administruara në seancë gjyqësore konstaton se ky pretendim eshte i pabazuar ne ligj.**

- Sipas ligjit nr. 66 date 18.05.1945 "Mbi perfundimin me ane arbitrazhi te detyruar te ceshtjeve civile te varura prane ish gjykatave", ne nenin 10 te tij rezulton



se, afati i apelit kunder vendimit te kolegjit arbitror eshte 10 dite nga shpallja. Nga kqyrja e rregjistrave te apeleve, prane arkives se Gjykates Durrës, te periudhes perkatëse rezulton se, kunder ketij vendimi nuk eshte paraqitur ankim. )

- Gjithashtu nuk rezulton qe te kete shenime mbi kete vendim per veprime te metejshme, apo gjykime te metejshme. Ne mungese te ankimit rezulton e provuar qe ky vendim eshte i formes se prere.

2. Për sa i përket pikës së dyte, ky vendim nuk ka vlere juridike pasi, nuk eshte rregjistruar ne rregjistrat e pasurive te paluajtshme, gjykata konstaton se ky pretendim eshte i pabazuar ne ligj.

- Vendimi gjyqësor i formes se prere ka fuqi per te gjithë institucionet, palet ndergjyqese dhe per ata qe marrin te drejta prej tyre. Vendimi gjyqësor nuk eshte veprim juridik. Nga ana e te paditurit Zyres Rajonale te Kthimit dhe kompesimit te Pronave Qarku Durrës dhe Agjencise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane eshte ngaterruar konceptim i veprimit juridik per kalimin e pronesise me vendimin gjyqësor. X

- Efektet e nje vendimi gjyqësor fillojne ne momentin qe vendimi merr forme te prere dhe ato humbasin ne rast se ky vendim prishet ose ndryshohet nga gjykatat me te larta. Ne kushtet kur rezulton e provuar se ky vendim gjyqësor nuk eshte ankimuar ai eshte i formes se prere. Ky vendim i ka te gjitha efektet qe ligji i jep vendimeve gjyqësore.

- Ne keto kushte gjykata cmon se rezulton e provuar se, bashkezetenes ne ciflikun Rrushkull te Shijakut jane Maria Lubica Shallvari, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, trashegimtaret e Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, sipas pjeseve perkatëse te tyre te percaktuar ne vendimin gjyqësor nr. 52 dt. 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durrësit i formuem me Kolegj Arbitrar.

- Nga vendimi gjyqësor nr. 52 dt. 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durrësit i formuem me Kolegj Arbitrar, rezulton e provuar qe testamenti i lene prej trashegimlensesit Miltiadh Shallvari ne favor te bashkeshortes Sllava Maria Lubica, eshte deklaruar i pavlefshem, pasi ne castin e perpilimit te tij, testatori ka qene ne paaftesi mendore per te disponuar me testament. Prova ?? e paaftësisë

- Ne kushtet e mesiperme, pasuria e tij nuk mund t'i nenshtrohej trashegimise testamentare, por asaj ligjore. Duke qene se trashegimlensesi Miltiadh Shallvari ka vdekur ne vitin 1933 atehere bashkezetenesit Maria Lubica Shallvari, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, trashegimtaret e Evdhoqes Goxhomari, Ariandhi Konomi, sipas pjeseve perkatëse te tyre kane fituar pronesine, qe ne momentin e celjes se trashegimise, ne castin e vdekjes se trashegimlensesit Miltiadh Shallvari, ne vitin 1933 dhe jo ne daten e marrjes forme te prere te vendimit.



- Gjithashtu, duke fituar pronesine trashëgimtare të kanë fituar edhe posedimin e kësaj pasurie, pavarësisht se nuk e kanë shtene në dorë efektivisht atë. Ky është një lloj posedimi i vecantë, i njohur vetëm në rastin e trashëgimit, ku trashëgimtarët fitojnë posedimin në rastin e vdekjes së trashëgimtarit, pavarësisht faktit nëse e kanë shtene në dorë ose jo pasurine efektivisht. Posedimi është një nga tagrat e pronarit. Meqenëse pronësia e fituar për shkak të trashëgimit, fitohet në rastin e celjes së trashëgimit, edhe posedimi fitohet në këtë rast. Në nenin 653 të Kodit Civil të vitit 1929 parashikohet shprehimisht se: “ *Posedimi i pasurisë së të vdekurit shkon ipso jure në personin e trashëgimtarit, pa qenë nevoja me të vu dorë materialisht asaj pasurie*”.

- Edhe ligji 9235 dt. 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” i ndryshuar, nuk e lidh asnjehere njohjen e kthimit apo kompensimit të pronës me faktin nëse pretenduesit ish-pronarë e kanë poseduar apo jo pronën. Është e pamundur që ish-pronarë të pronave me sipërfaqe të mëdha të posedonin vetë pronën, kjo provon edhe njëherë faktin se konkluzioni i të paditurit është i gabuar.

- Bazuar në sa më sipër trashëgimtarët Maria Lubica, Maria Lampo, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mika, trashëgimtarët e Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, janë bashkëzotues mbi objektin ciftliku Rrushkull, i cili është i percaktuar në objektin e padisë, pra kanë pasur një pronë e cila deri më 29.11.1944 nuk rezultoi të jetë shitur apo tjetërsuar prej tyre. Ky fakt vërtetohet edhe nga nota e transkriptimit të hipotekës Durrës, nr 126, dt 29.05.1946, ku prona e mesipërme e cila ishte marre në enfiteozë nga shoqëria EIIA, prej znj. Sllava Maria Lubica Lampo, konfiskohet dhe kalon në favor të shtetit Shqiptar.

**3. Për sa i përket pikës së tretë, e gjithë prona i është dhënë me enfiteozë për 99 vjet shoqërisë E.I.I.A. në vitin 1940 dhe me pas është sekuestruar nga shteti shqiptar në 29.05.1945 kësaj shoqërie, gjykata konstaton se edhe ky pretendim është i pabazuar në ligj.**

- Është e vërtetë që nga ana e njerit prej bashkëzotuesve (bashkëpronarëve) Maria Ljubica Shallvari është lidhur një kontratë enfiteoze me shoqërinë italiane EIIA, por kjo kontratë nga vetë përmbajtja e saj rezultoi të jetë nul, duke qenë se njeres prej paleve, i ka munguar çështja e pronarës së ligjshme, për të lidhur këtë kontratë.

- Përveç sa më sipër kontrata e enfiteozes, nuk është kontratë që ka për qëllim kalimin e pronës, por ajo ka për qëllim zhvillimin e pronës. Pronësia e sendit të paluajtshëm mbetet e enfiteozedhënesit. Në nenin 1530 të Kodit Civil të vitit 1929 (i cili ka qenë në fuqi në kohën e lidhjes së kontratës së enfiteozes), parashikohet se: “ *Enfiteozi është një kontratë, me të cilën i koncedohet një personi (enfiteozmarsi), një pronë, me detyrimin që ta përmirësojë dhe të paguaj një*



*prestim te pervitshem, qe quhet kanon dhe qe caktohet ne te holla ose drithna".*  
Neni 1532 po i Kodit Civil te vitit 1929 parashikon se: "*Enfiteosi mund te lidhet vlefesisht vetem prej atyne qe kane te drejte tjetersimi edhe me ato kondita dhe forma qe lypen per tjetersimin".*

Pra, gjykata cmon se eshte teresisht e provuar, cilesia si pronare mbi sendin objekt kerkimi deri me 29.11.1944 i trashegimlensesve te paditesave.

- Nga ana e te paditurit eshte argumentuar se pasuria e kerkuar eshte sekuestruar si pasuri e shtetasve italiane. Ky fakt, pra sekuestrimi i pasurie objekt gjykimi si rezultat i zbatimit te ketij ligji, nuk deshmon qe sekuestrimi ka qene i drejte. Sic u citua me lart shoqeria italiane EIIA nuk ka qene pronare e prones Cifliku Rushkull dhe Cifliku i ri, por ka qene vetem enfiteozmarese.

- Per vec kesaj, ne nenin 2 te ligjit 9235 dt. 29.07.2004, "Per kthimin dhe kompensimin e pronave" i ndryshuar, cilesohet se: legjitimohen te kerkojne kthimin apo kompesimin e prones ish-pronaret qe prona "*iu eshte marre sipas akteve ligjore dhe nenligjore, vendimeve penale te gjykatave ose marre me cdo menyre tjeter te padrejte nga shteti nga date 29.11.1944.*" Pra, edhe sipas argumentit te perdorur nga i padituri marrja e prones ne baze te nje ligji, te dale pas dates 29.11.1944 nuk i pengon paditesat te kerkojne pronen e tyre.

- Rezulton qe prona objekt kerkimi nuk eshte vetem e shtetasve italiane Maria Ljubica, por edhe e Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mika, trashegimtarete e Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, te cilet e kane fituar te drejten e tyre te pronesise qe ne vitin 1933. Ne keto kushte ky ligj nuk i shtrin efektet mbi pronen e shtetasve shqiptare te cituar me lart.

- Rezulton qe prona e paditesave eshte marre nga shteti ne baze te reformes agrare ne zbatim te ligjit nr 108 dt. 29.08.1945, dhe ky fakt provohet edhe nga vendimi gjyqesor nr. 52 date 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durrësit i formuem me Kolegj Arbitrar i Gjykates se Durrësit. Kjo gjykate ne pjesen e dispozitivit citon se: "*Ky vendim nuk mund te rregjistrohet ne hipoteke per shkak te veprimite reformes agrare".* Pra, per shkak te zbatimit mbi kete prone te ligjit nr. 108 dt. 29.08.1945 "Mbi reformen agrare", vendimi eshte i parregjistrueshem ne rregjistrat e pasurive te paluajtshme, dhe kjo eshte e bazuar ne nenin 1 te ligjit nr. 108. Duke qene se prona plotesonte kushtet e percaktuara ne kete ligj, ajo quhej e "shpronesuar" dhe u ndahej gratis bujqve sipas percaktimeve te nenev 8 e vijues te ketij ligji, te cilet beheshin zotenues te prones se perfituar.

- Edhe vete vendimi gjyqesor nr.52 date 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durrësit, ka njohur faktin se prona trashegimtareve te Miltiadh Shallvarit i eshte marre ne zbatim te ligjit nr. 108 dt. 29.08.1945, "Mbi reformen agrare" dhe jo me ndonje ligj tjeter.

**Perfundimisht,** rezulton e provuar se ne pronesi te Maria Lubica Shallvari, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mika, trashegimtarete e Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, sipas pjeseve te percaktuara ne vendimin nr. 52 date 02.03.1946 i Gjyqit Civil te Prefektures se Durrësit, ka qene cifliku Rushkull. Nga vendimi



Gjyqesor nr. 1 dt. 03.01.1997 i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Durres rezulton te jete percaktuar siperfaqja e prones se pretenduar dhe kufijte e rinj te saj.

Bazuar ne nenet 1 dhe 2 te ligjit 9235 dt. 29.07.2004 ,”Per kthimin dhe kompensimin e pronave” i ndryshuar, paditesat Ana Mitro(Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani, Eleni Mima dhe nderhyresit kryesor Polikseni Mima dhe Marjeta Mima, kane provuar te dy kushtet e kerkuara nga ligji per t’u quajtur ne baze te nenit 45 te ligjit 8485 dt. 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative te R.Sh.” si pale ne nje proces administrativ.

Sic dhe i padituri ka cituar kete dispozite paditesat dhe nderhyresit kryesore jane mbajtes te interesave te ligjshem. Rezultoi e provuar qe trashegimlensitet e tyre kane qene pronare te nje prone te paluajtshme e cila iu eshte marre ne menyre te padrejte nga shteti.

Gjykata, mbi bazen e kerkeses se paraqitur nga paditesat , duke u bazuar ne provat shkresore, notat e transkriptimit nxjerre nga Zyra e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme Durres te viteve 1919-1946, si dhe hartat e prones te nxjerra nga Arkivi Qendror i Shtetit, ne baze te nenit 224/a e vijues te K.Pr.Civile, mori proven me ekspert topograf nga Instituti i Topografise Ushtarake, per te percaktuar vendndodhjen, siperfaqen, dhe gjendjen juridike te prones se pretenduar nga paditesat dhe nderhyresit kryesor.

Nga akti i ekspertimit, rezultoi se:

1- Prona me siperfaqe 1 575 900 m<sup>2</sup>, e percaktuar, prona “A” ne akt ekspertim, ndodhet ne fshatin Hamallaj (sektor) te rrethit te Durresit ne ZK 1925, me indeks harte K-34-88-(144-B, 129-A, 129-B). Ajo ka keto kufij: Veri - pas. Nr.20/1, 21/9; Jug -vija ndarese midis fshatit Rrushkull, Perendim -deti; Lindje -pas. Nr.21/9, 21/10, 134. Brenda saj kjo prone permban pasurite nr 20, 21/3, 21/4, 21/5, 21/6, 21/7, 50/1 dhe 50/2.

Kjo prone eshte e perbere nga toke pyll, kenete, ranishte dhe kanal. Siperfaqja e kanalit eshte 16.400m<sup>2</sup>. Bregu i detit, (ne kuptim te ligjit nr 8093, dt 21.03.1996, “Per rezervat ujore” i ndryshuar), perbehet nga toke ranishte dhe qe ze nje siperfaqe totale prej 52 000m<sup>2</sup>. Rezulton te jete e lire siperfaqja prej 1507 500 m<sup>2</sup> (150.75 ha), ne kuptim te ligjit nr 9235 dt 29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e Pronave”.

2 - Prona me siperfaqe 1 820 000 m<sup>2</sup>, e percaktuar, prona “B” ne akt ekspertim, e ndodhet ne fshatin Hamallaj (sektor) te rrethit te Durresit, ne ZK 1925, me indeks harte K-34-88-(144-B, 146-A, 129-D, 161-B) Ajo ka keto kufij: Veri- pas. Nr. 49, 54/2, 133/2 e kanali i hidrovorit; Jug -vija ndarese midis fshatit Rrushkull-Hamllaj (sektor). Perendim -pasuria nr. 21/8, 21/6; Lindje -pas. Nr.133/2, 49, 139, 146, 87.



o prone eshte e perbere nga siperfaqe pyll prej 4.5 ha, siperfaqe toke are 134.37 toke pa fryt 11.46 ha, kanal 12.56 ha, rruge 1.65 ha si dhe siperfaqja prej 17.25 prej te cilave paditesat hoqen dore duke pakesuar objektin e padise, pasi ato ishin okupuara me ndertim, e pranuar nga gjykata bazuar ne nenin 185 te K.Pr.Civile.

jo siperfaqe permban keto nr pasurie, 23, 24/1, 24/2, 22/2, 22/1, 54/2, 49, 51/1, 1/3, 51/2, 53/3, 53/1, 53/2, 82/2, 82/1, 85, 84, 83, 52/1, 52/2, 52/3, 52/4, 134, 187, 36, 140, 185/2, 185/3, 185/4, 147, 147/1, 139, 135, 185/1, 138/1, 54/1

rezulton te jete e lire siperfaqja prej 1505 400 m2 (150.54 ha), ne kuptim te ligjit nr 235 dt 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave".

b - Prona me siperfaqe **25 597 200 m2**, e percaktuar, prona "C" ne akt ekspertim, e prodhur ne fshatin Rrushkull ne ZK 3241, me indeks harte te papercaktuar, pasi zona eshte jashte sistemit te ZVRPP Durres dhe ka keto kufij natyrale: Veri- Prona e vet; Jug- Lumi Erzen; Perendim - Deti, Lindje Qani Hanem dhe Fuat Bej Toptani,

Ne aplikimin e notave te transkriptimit kjo siperfaqe nuk rezulton 25 597 200 m2, por me siperfaqe 22 294 100 m2.

Nga konkluzionet e aktit te ekspertimit, i cili eshte bazuar ne te dhenat e afuara nga Z.V.R.P.P.Durres, Seksioni i administrimit te tokes Bashkia Sukth dhe Keshilli i Qakrut Durres, rezulton se **siperfaqja e tokes shtet, eshte 8 508 500m2 (850.85 ha)**, ndersa pjesa tjeter prej **13 785 500m2**, eshte ndare nga ligji nr 7501 "Per token".

Gjithashtu rezultoi se siperfaqja prej 850.85 ha perbehet nga, 486.35 ha toke pyll, 340 ha toke are, 12.5 ha toke kanal, 1.6 ha rruge dhe 9 ha toke rrere (breg deti), e part ushtarak me siperfaqe 2000 m2 nga e cila paditesat hoqen dore duke pakesuar objektin e padise, e pranuar nga gjykata bazuar ne nenin 185 te K.Pr.Civile.

Kufizimet e saj jane: V- pronat a, b, dhe pasuria nr 87/1; L- pasurite nr 2,3,4,5,24,45, 50,49,138,139,140; J- lumi Erzen dhe pasurite nr 134, 30,138,41/1, 42/1, 45; P- bregu i detit Adriatik.

Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te ceshtjes, Gjykata pasi analizoi ne teresi pretendimet dhe prapesimet e paleve ndergjyqese, pasi analizoi ne teresi te gjitha provat shkresore te paraqitura prej tyre ne gjykim, arrin ne konkluzionin perfundimtar se kerkesepadia eshte e mbeshtetur ne ligj dhe ne prova dhe si e tille het te pranohet. Vendimet e dhena nga Zyra Rajonale e Kthimit dhe Kompensimit Pronave Qarku Durres dhe ato te Agjensise Qendrore te Kthimit te Pronave ane, duhet te ndryshohen pasi nuk jane te mbeshtetura ne ligj dhe ne prova. Duke azuar ne dispozitat ligjore te parashikuara ne ligjin nr 9235, dt 29.07.2004, "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave", trashegimtareve te ishpronareve, Jorgji Vecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, etj, duhet tu njihet e drejta e pronesise mbi



asurine e paluajtshme te pretenduar prej tyre, duke ju kthyer ne natyre siperfaqja e prones qe rezulton te jete e lire ne kuptim te ligjit nr 9235 dt 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave", si dhe tu njihet e drejta e kompensimit per siperfaqen e tokes qe konsiderohet e zene po ne kuptim te ketij ligji.

Ne nenin 1 te ligjit Nr. 9235, datë 29.7.2004, "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar percaktohet se: Ky ligj ka për objekt:

- a) rregullimin e drejtë, sipas kriterëve të nenit 41 të Kushtetutës, të çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet;
- b) kthimin dhe, aty ku sipas këtij ligji kthimi i pronës është i pamundur, kompensimin e saj;
- c) procedurat për realizimin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si dhe organet administrative të ngarkuara për realizimin e tyre.

Neni 2, percakton se:

Çdo subjekt i shpronësuar ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me këtë ligj, të drejtën e pronësisë, në rast se i është hequr sipas akteve ligjore, nënligjore, vendimeve penale të gjykatave ose të marrë me çdo mënyrë tjetër të padrejtë nga shteti nga data 29.11.1944, si dhe kthimin ose kompensimin e pronës.

Neni 6 percakton se:

1. Subjekteve të shpronësuar u njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen pa kufizim pronat e paluajtshme, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kthehet ose kompensohet deri në 100 ha, në rast se subjekti i shpronësuar (trashëgimtarët e tij) nuk kanë përfituar nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën".

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/a, 1/b, 1/c dhe 1/ç me këtë përmbajtje:

1/a. Kur subjekti i shpronësuar (trashëgimtarët e tij) kanë përfituar tokë nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", atëherë sipërfaqja që kthehet apo kompensohet, sipas këtij ligji, llogaritet si diferencë ndërmjet pjesës, që do t'i takonte në kushtet e mospërfitimit nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", me sipërfaqen, që secili prej tyre ka përfituar nga zbatimi i këtij ligji.

1/b. U njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen subjekteve të shpronësuar, sipas kriterëve të këtij ligji, edhe pasuritë e paluajtshme, toka me vendndodhje brenda territoreve turistike, sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", të ndryshuar.

1/c. Subjekteve të shpronësuar u kthehen të gjitha pronat e paluajtshme në pronësi apo përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, por që janë jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, të miratuara nga Presidenti i Republikës dhe tokat bujqësore të përfshira në veprimtaritë eksperimentale-shkencore të instituteve kërkimore-shkencore dhe në çdo veprimtari tjetër të institucioneve të ndryshme shtetërore, por që janë jashtë destinacionit të veprimtarisë së tyre.

1/ç. Në rastet kur në pronën e marrë me qira është ndryshuar destinacioni i objekteve të ndërtuara, për të cilën është rënë dakord për t'i përdorur për veprimtari të stimuluar, toka quhet e pazënë dhe i kthehet subjektit të shpronësuar.



3. Subjektet e shpronësuar dhe të kompensuar sipas ligjeve në fuqi kanë të drejtën e përfitimit nga ky ligj vetëm për pjesën e pronës së pakthyer ose të pakompensuar.

Neni 7 përcakton pronat që nuk kthehen:

1. Nuk kthehen pronat e paluajtshme, që i shërbejnë një interesi publik dhe ato që:
  - a) shërbejnë për realizimin e detyrimeve të shtetit shqiptar, që rrjedhin nga traktatet dhe konventat, në të cilat shteti ynë është palë;
  - b) janë të zëna sipas akteve ligjore, paraqitur në shtojcën 1 të ligjit.
2. Në rast se pronat e paluajtshme, që përfshihen në pikën 1 të këtij neni, propozohen të tjetërsohen, ato u kalojnë subjekteve të shpronësuar kur këto nuk janë kompensuar.
3. Pronat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni kompensohen sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj.”.

Ne interpretim të dispozitave të mesiperme ligjore, vecanerisht përcaktimet e parashikuara në nenet 6 dhe 7 të ligjit nr 9235, dt 29.07.2004 “Per kthimin dhe kompensimin e Pronave” i ndryshuar, Gjykata konstaton se, subjekteve të shpronësuar u njihet e drejta e pronësive dhe u kthehet në natyrë e gjithë pasuria e paluajtshme (prona), pa asnjë kufizim.

Perjashtimi i vetëm që parashikohet në këtë rast është ai i përcaktuar në nenin 6 të këtij ligji, që bën fjalë, vetëm për sipërfaqen e tokës bujqësore që u kthehet ishpronarëve në natyrë, e cila nuk mund të jetë më e madhe se 100 ha për çdo ish-pronar.

Duke u kthyer në rastin konkret, Gjykata konstaton se ish pronar në momentin e shpronësimit (29.11.1944) në pasurinë “Cifliku Rrushkull dhe Cifliku i Ri” kanë qenë gjashtë bashkezetues (bashkepronar) konkretisht, Sllava Maria Lubica Lampo, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani dhe Arjadhni Konomi, atëherë secili prej këtyre, pronarëve të shpronësuar (trashëgimtarët e tyre) gezojnë të drejtën e kthimit në natyrë të një sipërfaqe toke bujqësore deri në 100 ha për secilin dhe në total shumën e tokës bujqësore që u kthehet atyre në natyrë arrin në një maksimum prej 600 ha.

Sipas përcaktimeve të nenit 6/1/a), nga sipërfaqja maksimale e tokës bujqësore prej 100 ha, që përfiton secili ish-pronar i shpronësuar, zbritet sipërfaqja e tokës që ish-pronari ka përfituar nëpërmjet ligjit nr 7501, “Per token”. Në gjykim rezultoi se nga të gjithë trashëgimtarët e ish-pronarëve, vetëm trashëgimtarët e ishpronarës Arjadhni Konomi, kanë përfituar toke bujqësore në total 9500m<sup>2</sup>, ndërsa trashëgimtarët e ish-pronarëve të tjerë, nuk kanë përfituar toke bujqësore nga ligji “Per token”.



Pavaresisht faktit te mesiperm Gkykata konstaton se siperfaqja e tokes bujqesore qe perfitojne trashegimtaret e ish-pronareve, duke u bazuar ne konkluzionet e aktit te ekspertimit eshte 474,37 ha, rrjedhimisht edhe siperfaqja e tokes bujqesore qe perfiton seicili ish-pronar eshte me e vogel se 100 ha.

Bazuar ne sa me siper, aplikimi i percaktimeve te nenit 6/1/a) te ligjit nr 9235, dt 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar, per trashegimtaret e ish-pronares Ariadhni Konomi, nuk gjen zbatim ne rastin konkret, pasi siperfaqja e tokes bujqesore qe perfitojne trashegimtaret e saj eshte me e vogel se 100 ha.

1- Persa i perket vendimit nr. 384 dt. 04.01.2008 te Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Qarku Durres lene ne fuqi me vendimin nr. 1070 dt. 24.09.2008 te Agjencise se Kthimit dhe Kompesimit te Pronave Tirane eshte vendosur: "Mos njohja e te drejtes se pronesise trashegimtareve te subjekteve pretendues si te shpronesuara Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani, Ariandhi Konomi, qe dalin nga deshmitet e trashegimive te dhena ne piken 3 te te ketij vendimi, per pronen me siperfaqe 1 575 900 m2 e ndodhur ne fshatin Hamallaj (sektor) te rrethit te Durresit ne ZK 1925, me indeks harte K-34-88-(144-B, 129-A, 129-B) me keto kufij: Veriu pas. Nr.20/1, 21/9; Jug - vija ndarese midis fshatit Rrushkull, Perendim -deti, Lindje -pas. Nr.21/9, 21/10, 134, Gjykata konkludon se, vendimi i mesiperm duhet te ndryshohet dhe trashegimtareve te ishpronareve Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani dhe Arjadhni Konomi, duhet tu njihet e drejta e pronesise mbi kete siperfaqe.

Nga konkluzionet e aktit te ekspertimit rezulton se, brenda saj kjo prone permban pasurite nr 20, 21/3, 21/4, 21/5, 21/6, 21/7, 50/1 dhe 50/2. Kjo prone eshte e perbere nga toke pyll, kenete, ranishte dhe kanal. Siperfaqja e kanalit eshte 16.400m2. Bregu i detit, (ne kuptim te ligjit nr 8093, dt 21.03.1996, "Per rezervat ujore" i ndryshuar), perbehet nga toke ranishte dhe qe ze nje siperfaqe totale prej 52 000m2.

Duke mbajtur parasysh percaktimet e nenit 6 te ligjit nr 9235, dt 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar, Gjykata vlereson se nga siperfaqja totale prej 1575.900 m2 e pretenduar nga paditesit, atyre duhet tu kthehet ne natyre siperfaqja prej 1507 500 m2 (150.75 ha), e cila rezulton te jete e lire, (pjesa e ngjyrosur me ngjyre roze ne hartën qe i bashkëngjitet aktit te ekspertimit).

Pjesa tjeter prej 52 000 m2 ranishte dhe 16 400 m2 kanal, nuk do tu kthehet ne natyre, pasi ndalohet nga neni 7 i Ligjit "per kthimin e Pronave", por ish-pronaret do te kompensohen per kete siperfaqe.



ona eshte jashte sistemit te ZVRPP Durres me keto kufij natyrale: Veriu Prona e vet, Jug-Lumi Erzen, Perendim Deti, Lindje Qani Hanem dhe Fuat Bej Toptani, Gjykata konkludon se, vendimi i mesiperm duhet te ndryshohet dhe trashegimtareve te ish-pronareve Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Kostandin Mima, Evdhoqes Goxhomani dhe Arjadhni Konomi, duhet tu njihet e drejta e pronesise mbi kete siperfaqe.

Bazuar ne konkluzionet e aktit te ekspertimit, siperfaqja e trete e disponuar nga zyrat e kthimit te pronave nuk eshte 25.597.200 m2 aq sa eshte pretenduar nga paditesat, por duke u bazuar ne aplikimin e notave te transkriptimit kjo siperfaqe rezulton te jete

**22 294 100 m2 dhe pikerisht per kete siperfaqe paditesave do tu njihet e drejta e pronesise.**

Nga konkluzionet e aktit te ekspertimit, i cili eshte bazuar ne te dhenat e afruara nga Z.V.R.P.P.Durres, Seksioni i administrimit te tokes Bashkia Sukth dhe Keshilli i Qakrut Durres, rezulton se **siperfaqja e tokes shtet, eshte 8 508 500m2 (850.85 ha)**, ndersa pjesa tjeter prej **13 785 500m2, eshte ndare nga ligji nr 7501 "Per token"**.

Siperfaqja prej 850.85 ha perbehet nga: 486.35 ha toke pyll, 340 ha toke are, 12.5 ha toke kanal, 1.6 ha rruge dhe 9 ha toke rrere (breg deti). Kufizimet e saj jane: V- pronat a, b, dhe pasuria nr 87/1; L- pasurite nr 1,2,3,4,5,24,45, 50,49,138,139,140; J- lumi Erzen dhe pasurite nr 134, 130,138,41/1, 42/1, 45; P- bregu i detit Adriatik.

Bazuar ne kriteret e percaktuara ne ligjin nr 9235 dt 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar, Gjykata vlereson se ish-pronareve duhet tu kthehet ne natyre siperfaqja prej 8 263 500m2 (826,35ha), pjesa e ngjyrosur me ngjyre jeshile ne aktin e ekspertimit, ndersa per siperfaqen prej 24.5 ha qe eshte e zene me kanal, rruge, dhe rere e paster (breg deti), repart ushtarak me siperfaqe 2000 m2 nga e cila paditesat hoqen dore duke pakesuar objektin e padise, e pranuar nga gjykata bazuar ne nenin 185 te K.Pr.Civile, ish-pronareve duhet tu njihet e drejta e kompensimit.

Ish-pronaret do te kompensohen edhe per siperfaqen prej 1375,55 ha qe eshte ndare me ligjin 7501 "Per token".

Persa i perket pjeseve te zena nga reparti ushtarak, trashegimtareve ligjor te ish-pronareve bazuar ne nenin 14 te ligjit nr 9235, dt 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar do tu njihet e drejta e parablerjes se ketyre godinave ne rast privatizimi.



## PER KETO ARSYE

Gjykata bazuar ne nenet 6, 7, te ligjit nr 9235, dt 27.09.2004, "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar dhe 126 e 331 te Kodit te Procedures Civile

### V E N D O S I

1- Pranimin e kërkesë padisë së paditësave, Ana Mitro(Vevecka), Fotaq Konomi, Vasillaq Goxhomani Eleni Mima dhe të nderhyresave kryesore, Polikseni Mima e Marjeta Mima.

2- Ndryshimin e Vendimit Nr. 384, date 04.01.2008 te Zyres Rajonale te Kthimit Kompesimit Pronave te Qarkut Durres dhe Vendimit Nr. 1070, date 24.09.2008 te Agjensise se Kthimit Kompesimit Pronave Tirane, si me poshte:

a) U njihet e drejta e pronesise trashegimtareve ligjor te ish pronareve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdhogja Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, mbi nje siperfaqe toke **1.575.900 m<sup>2</sup>**

( 157.59 ha ), prona "A" e ndodhur ne fshatin Hamallaj Durres, Zona Kadastare Nr. 1925, Indeksi i hartes K - 34 - 88 - ( 144 - B, 129 - A, 129 - B ),

e kufizuar:

Veri	-	Pasuria Nr. 20/1, 21/9
Jug	-	Vija ndarese e fshatit Rrushkull
Perendim	-	Bregu i detit Adriatik
Lindje	-	Pasuria Nr. 134 (kanal)

(e pasqyruar me ngjyre roze ne harten qe i bashkengjitet aktit te ekspertimit).

Nga kjo siperfaqe:

b) U kthehet ne natyre siperfaqja e lire **1.507.500 m<sup>2</sup>** ( 150.75 ha ), e ndodhur brenda prones "A" me kufizimet :

Veri	-	Pasuria Nr. 20/1, 21/9
Jug	-	Vija ndarese e fshatit Rrushkull
Perendim	-	Bregu i detit Adriatik
Lindje	-	Pasuria Nr. 134 (kanal)

(e pasqyruar me ngjyre roze ne harten qe i bashkengjitet aktit te ekspertimit).

c) U Kompesohet siperfaqja e zene **68.400 m<sup>2</sup>** (6.84 ha), ne baze te nenit 11/15 te ligjit Nr.9235, date 29.07.2004 i ndryshuar.



- Ndryshimin e vendimit Nr. 380, date 28.12.2007 te Zyres Rajonale te Kthimit Kompesimit Pronave te Qarkut Durres dhe Vendimit Nr. 1069, date 24.09.2008 te Agjensise se Kthimit Kompesimit Pronave Tirane, si me poshte:

a) U **njihet e drejta** e pronesise trashegimtareve ligjor te ish pronareve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, mbi nje siperfaqe toke **1.647.000 m<sup>2</sup>** (164.70 ha), prona "B", e ndodhur ne fshatin **Hamallaj** Durres, Zona Kadastare - Nr. 1925, Indeksi i hartes-K - 34 - 88 (144 - B, 146 - A, 129 - D, 161 - B), e kufizuar:

Veri - Pasurite Nr. 20/1, 133/2  
Jug - Vija ndarese e fshatit Rrushkull  
Perendim - Pasuria 134 (kanal)  
Lindje - Pasurite Nr. 133/2, 137, 49, 146, 187

(e pasqyruar me ngjyre portokalli ne harten qe i bashkengjitet aktit te ekspertimit).

Nga kjo siperfaqe:

b) U **kthehet ne natyre** siperfaqja e lire **1.505.400 m<sup>2</sup>** ( 150.54 ha ) e ndodhur brenda prones "B" me kufizimet :

Veri - Pasurite Nr. 20/1, 133/2  
Jug - Vija ndarese e fshatit Rrushkull  
Perendim - Pasuria 134 (kanal)  
Lindje - Pasurite Nr. 133/2, 137, 49, 146, 187

(e pasqyruar me ngjyre portokalli ne harten qe i bashkengjitet aktit te ekspertimit).

c) U **Kompesohet** siperfaqja e zene **144.200 m<sup>2</sup>** ( 14,42 ha ) ne baze te nenit 11/15 te ligjit Nr.9235, date 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar.

4- Ndryshimin e Vendimit Nr. 379, date 28.12.2007 te Zyres Rajonale te A.K.K.P. - se te Qarkut Durres dhe Nr.1071, date 24.9.2008 te A.K.K.P. - se Tirane dhe :

a) U **njihet e drejta** e pronesise trashegimtareve ligjor te ish pronareve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, mbi nje siperfaqe toke **22.294.100 m<sup>2</sup>** ( 2229.41 ha ), prona "C", e ndodhur ne fshatin **Rrushkull**, Zona Kadastrale Nr. 3241, Indeksi i hartes - e pa percaktuar pasi zona eshte jashte sistemit te Z.V.R.P.P. - Durres, e kufizuar:

Veri - Pronat "a" dhe "b" dhe pasuria Nr. 87/1  
Jug - Lumi Erzen dhe pasurite Nr. 138, 134, 137, 130, 41/1, 42/1, 42/2, 45.



- Perendim - Bregu i detit Adriatik  
Lindje - Pasurite Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 24, 45, 49, 50, 138, 139, 140  
(e pasqyruar me ngjyre jeshile ne harten qe i bashkengjitet aktit te ekspertimit).

Nga kjo siperfaqe:

b) U kthehet ne natyre siperfaqja e lire **8.263.500 m<sup>2</sup>** ( 826,35 ha ), e ndodhur brenda prones "C", me kufizimet :

- Veri - Pronat "a" dhe "b" dhe pasuria Nr. 87/1  
Jug - Lumi Erzen dhe pasurite Nr. 138, 134, 137, 130, 41/1, 42/1, 42/2, 45.

- Perendim - Bregu i detit Adriatik  
Lindje - Pasurite Nr. 1, 2, 3, 4, 5, 24, 45, 49, 50, 138, 139, 140

(e pasqyruar me ngjyre jeshile ne harten qe i bashkengjitet aktit te ekspertimit).

c) U kompesohet siperfaqja e zene **14.030.600 m<sup>2</sup>** ( 140, 306 ha ) ne baze te nenit 11/15 te ligjit Nr.9235, date 29.07.2004 "Per kthimin dhe kompensimin e Pronave" i ndryshuar

d) Trashegimtareve ligjor te ish pronareve, Jorgji Vevecka, Sofia Kolea, Konstandin Mima, Evdhoqia Goxhomani, Ariadhni Konomi dhe Sllava Ljubica Maria Amalia Llampo, ne baze te nenit 14 te ligjit Nr.9235, date 29.07.2004 i ndryshuar, u njihet e drejta e parablerjes per godinat e ndertuara brenda prones "C", ne rast privatizimi ( rep. ushtarak dhe 2 godinat shteterore).

5- Ligjerimin e mases se sigurimit te padis, marre nga Gjykata me vendim te ndermjetem ne seance gjyqesore te dates 09.09.2009.

6- Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te paditurit.

7- Kundër vendimit mund te behet ankim në Gjykatën e Apelit Durrës brenda 15 ditëve, nga e nesërmyja e shpalljes së vendimit.

U shpall në Durrës, sot më dt 05.10.2009.

**GJYQTAR**  
**Markelian KOÇA**



**GJYQTAR**  
**Dhurata BILO**



**GJYQTAR**  
**Ervin METALLA**

